

VENDIM
Nr. 730, datë 28.8.2013

**PËR LEJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE SI AUTORITET
KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR
BLERJE PULLASH KONTROLLI ME ELEMENT SIGURIE PËR BARNAT DHE AKSESORË
PËR SHTYPJEN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, ai autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik me objekt “Blerje pullash kontrolli me element sigurie për barnat dhe aksesore për shtypjen e tyre” me fond limit 8 400 000 (tetë milionë e katërqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha